



KOMUNA E ISTOGUT
Opstina Istok
Municipality of Istog

POLITIKA E PRIVATËSISË

Përmbajtja:

Politika e Privatësisë

Kush i përpunon dhe është përgjegjës për të dhënat tuaja personale?

Kategoria e të dhënave që përpunojmë?

Për çfarë qëllimesh i përdorim të dhënat tuaja personale?

Baza ligjore për përpunim

Me kë i ndajmë të dhënat personale të mbledhura?

Cilat janë të drejtat tuaja?

E drejta e ankimit

Siguria e të dhënave personale

Përditësimi i Politikës së Privatësisë

Politika e Privatësisë

E drejta e privatësisë dhe mbrojtja e të dhënave tuaja personale është prioritet kryesor i Komunës së Istogut-, i cili angazhohet të përpunojë të dhënat tuaja personale me përgjegjësi dhe në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe në pajtim me legjislacionin evropian për mbrojtjen e të dhënave personale.

Kjo politikë e mbrojtjes së të dhënave personale është e zbatueshme nëse jeni aplikant për punë, palë kontraktuese, merrni pjesë në një trajnim të organizuar nga ne, vizitoni <https://istog.rks-gov.net/politikate-privatesise/> përdorni ndonjë shërbim, paraqisni kërkesë përmes email-it apo faqës tonë të internetit.

Kush i përpunon dhe është përgjegjës për të dhënat tuaja personale?

Përpunues i të dhënave personale është, Komuna e Istogut, Rr, “Fadil Ferati” 31000 Istog

Zyrtari përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale është Faton BYTYÇI, me Nr. Tel. 038 200 43 843 dhe e-mail: faton.bytyqi@rks-gov.net

Kategoria e të dhënave që përpunojmë?

Në varësi të qëllimeve dhe arsyeve specifike, Komuna e Istogut, përpunon të gjitha ose disa nga të dhënat personale të specifikuar më poshtë, ndaras ose në kombinim midis tyre:

Të dhënat e identifikimit: emri, mbiemri, të dhënat e dokumentit të identitetit;

Të dhënat e kontaktit: adresa, email, numri i telefonit;

Të dhëna për arsimin, shëndetin, kualifikimin profesional dhe veprimtarinë e punës;

Të dhëna të tjera të kërkuara sipas ligjeve të veçanta që rregullojnë marrëdhëniet e punës ose marrëdhëniet kontraktuale;

Informacione të tjera dhe të dhëna personale të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve statutores të palëve për të garantuar sigurinë në ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror;

Foto dhe video nga konferenca apo ngjarje;

Për çfarë qëllimesh i përdorim të dhënat tuaja personale?

Përmbushja e detyrimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në fuqi dhe të Bashkimit Evropian për mbrojtjen e të dhënave personale.

Përmbushja e urdhrave të organeve kompetente shtetërore;

Përzgjedhja e punonjësve, duke përfshirë kryerjen e trajnimeve të specializuara dhe gjuhësore për rekrutimet të reja;

Lidhja e kontratave dhe marrëdhënieve parakontraktuale;

Garantimi i sigurisë së punonjësve, vizitorëve, si dhe infrastrukturës së ndërmarrjes, përmes sistemit të mbikëqyrjes video, sigurisë fizike, kontrollit të qasjes dhe regjistrimit të vizitorëve të jashtëm;

Sigurimi i funksionimit normal, mirëmbajtjes dhe sigurisë së faqes së internetit dhe sistemeve të informacionit dhe komunikimit të Komunes së Istogut;

Organizimi dhe realizimi i trajnimeve të specializuara nga Organizata Trajnuese në Komunë;

Përpunimi i kërkesave sipas Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike;

Promovimi i aktiviteteve të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për duke përfshirë shpërndarjen e materialeve dhe broshurave reklamuese, postimin e fotove / videove në web faqe, Facebook, Instagram, Twitter, LinkedIn ose në media tjera.

Baza ligjore për përpunim

Komuna përpunon të dhënat personale të subjekteve bazuar në Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe në pajtim me legjislacionin evropian për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në disa raste, ne përpunojmë të dhënat personale vetëm pas pëlqimit paraprak të subjektit të të dhënave. Pëlqimi i dhënë mund të tërhiqet në çdo kohë nga subjekti.

Me kë i ndajmë të dhënat personale të mbledhura?

Autoritetet kompetente siç janë ato të sigurisë, gjyqësore dhe mbikëqyrëse, që në bazë të një akti juridik kanë autoritetin të kërkojnë nga Komuna të dhënat personale për subjektet e caktuara.

Cilat janë të drejtat tuaja?

Kur të dhënat tuaja personale përpunohen nga Komuna-Zyrtari përgjegjës, ju keni të drejtë:

të qasjes në të dhënat tuaja dhe në çdo kohë, të kërkonit t'i korrigjoni dhe përditësoni pa vonesë nëse të dhënat tuaja janë të pasakta ose jo të plota;
të fshirjes ('e drejta për t'u harruar) së të dhënave tuaja dhe mund të kërkonit që përpunimi të ndalohet në rrethana të caktuara;
të kërkonit që ndonjë nga ndryshimet e mësipërme t'u komunikohet palëve të tjera, të cilave u janë zbuluar të dhënat tuaja;
të ankoheni në çdo kohë nëse besoni se të drejtat tuaja për mbrojtjen e të dhënave janë shkelur.

E drejta e ankimit

Në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, çdo person fizik që beson se i është shkelur e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale, mund të paraqesë ankesë pranë Agjencisë për informim dhe Privatësi me adresë: Rr. Zejnel Salihu - Nr.22, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Siguria e të dhënave personale

Komuna, zbaton masat e duhura fizike, organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat tuaja personale në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave personale varet nga qëllimet e përpunimit për të cilat ato janë mbledhur dhe është e rregulluar me Ligjin përkatës për Arkivat Shtetërore ose me ndonjë ligj tjetër përkatës.

Përditësimi i Politikës së Privatësisë

Ne mund të përditësojmë herë pas here politikën tonë të privatësisë dhe do t'ju njoftojmë për çdo ndryshim duke postuar Politikën e re të privatësisë në këtë faqe.

Faqja e internetit mund të përmbajë linqe të ndryshme të faqeve të tjera të internetit, për të cilat ju rekomandojmë të i lexoni politikat e privatësisë të faqeve të tyre.